



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 shtator 2021
Nr. ref.:RK 1852/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KERKESËS

në

rastin nr. KI135/21

Parashtrues

Isuf Musliu

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të
paspecifikuar të autoritetit publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Isuf Musliu (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt konkret të autoriteteve publike por thekson se kontestohet *“Akti Konkret që toka 5.27 hek, është e imja e paguar më 1980 e dokumentuar nga noterët kontratat e shitblerjes ekspertizat etj.”*

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar saktë aktin e autoritet publik që konteston para Gjykatës e as nuk ka cekur në mënyrë specifike ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), për të cilën konsideron se është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 5 gusht 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë kërkesën me dokumentet dhe informatat si në vijim:
 1. të specifikoni saktë aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestoni para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
 2. t'i sqaroni ankesat tuaja sipas Kushtetutës;
 3. t'i dorëzoni në Gjykatë kopjet e të gjitha vendimeve që ndërliohen me rastin tuaj. Kjo, pasi në dosjen e lëndës ashtu si është dorëzuar në Gjykatë, rezulton se më 13 shtator 2019 keni paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit C.nr.296/16 të 18 qershorit 2019 dhe se më 5 nëntor 2020, Gjykata e Apelit ka vendosur lidhur me këtë ankesë përmes Vendimit CA.nr.4938/2019, por të cilat nuk janë dorëzuar në Gjykatë;
 4. të njoftoni Gjykatën nëse lidhur me Vendimin e Gjykatës së Apelit, CA.nr.4938/2019, të 5 nëntorit 2020, keni ushtruar ndonjë mjet juridik.

8. Më 10 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë në të cilën theksoi se lënda e tij *“Sot mban këtë numër C.nr. 296/16 pa gjykuar dhe nuk dihet në cilën Gjykatë gjindet në Themelore Apelit ose njëra tjetra nuk më jep informacion”*. Në përgjigje të pyetjeve të Gjykatës përmes shkresës së datës 5 gusht 2021, ai thekson se kontestohet *“Akti Konkret që toka 5.27 hek, është e imja e paguar më 1980 e dokumentuar nga noterët kontratat e shitblerjes ekspertizat etj.”* Ai po ashtu thekson se ankesat e tij janë *“në të gjitha institucionet e Kosovës duke përfshirë gjykatën e juaj, por është ra në vesh të shurdhur dhe nuk kam përgjigje”* dhe se *“deri më tash i kam dorëzuar të gjitha vendimet e marra nga këto 2 gjykata [...] por nuk kam përgjigje [...]”*. Ai gjithashtu ka dorëzuar disa dokumente të cilat ishin dorëzuar edhe më herët në Gjykatë.
9. Më 24 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C.nr.296/16] të 18 qershorit 2019, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C.nr.405/19] të 9 korrikut 2019.
10. Më 8 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shitesë, duke përfshirë Aktvendimin [GJA.nr.2020/2021] të Gjykatës Themelore me të cilin ishte aprovuar kërkesa e Gjyqtarit A.G. për përjashtim nga procedimi dhe vendosja e rastit në çështjen kontestimore C.nr.931/2020.
11. Më 10 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtë.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës lidhur me këtë rast parashtron kërkesë në Gjykatë për herë të tretë.
13. Në vazhdim, Gjykata do të bëjë përmbledhjen e fakteve lidhur me kërkesën e tanishme KI135/21, si dhe të kërkesës së parë KI18/18 dhe KI110/18 për aq sa ato ndërlidhen edhe me kërkesën e tanishme.
14. Më 2 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore për anulimin e kontratës mbi dhuratën e lidhur ndërmjet F. M., në njërën anë dhe H. M., A. M. dhe A. M., në anën tjetër, lidhur me një numër të ngastrave kadastrale në fshatin Pjetershticë, komuna e Shtimes (në tekstin e mëtejme: ngastrat e kontestuar) dhe kërkoi që Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) t’ia vërtetojë parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë në ngastrat e kontestuar.
15. Më 9 shtator 2013, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 210/11, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 210/11.

17. Më 15 korrik 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit CA.nr.3781/2013, e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 210/11, dhe e ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore, ku lënda është regjistruar me numrin e ri C. nr. 296/16. Gjykata e Apelit vërtetoi se Gjykata Themelore bëri shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 197 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase nuk e kishte hapur shqyrtimin e plotë për vërtetimin e faktit të kontestuar nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë kontribut për ngastrat e kontestuar të cilat kanë qenë objekt i kontratës së dhuratës.
18. Më 13 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese, kërkesën KI18/18, duke kontestuar kohëzgjatjen e procedurave lidhur me rastin e tij para Gjykatës Themelore.
19. Më 30 maj 2018, Gjykata shqyrtoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe nxori Aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës në rastin KI18/18. Në Aktvendimin për papranueshmëri, Gjykata gjeti se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave pranë gjykatave të rregullta, prej 6 (gjashtë) vitesh dhe gjashtë muaj, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit si dhe sjelljen e të gjitha palëve në procedurë.
20. Më 3 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI110/18 në Gjykatë.
21. Më 27 nëntor 2018, Gjykata shqyrtoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi se kërkesa KI110/18 e parashtruesit të kërkesës është përsëritje e një kërkesë të mëparshme për çështjen e cila tashmë është vendosur nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kjo kërkesë u refuzua me procedurë të shkurtër.
22. Nga dosja e lëndës rezulton se më 18 qershor 2019, lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Themelore ka nxjerrë Aktvendimin [C.nr.296/16], me të cilin kishte veçuar procedurën sipas kundërpaditësit H.M., ndaj të cilit parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Për më tepër, sipas shkresave të lëndës, rezulton se edhe Gjykata e Apelit ka nxjerrë një vendim lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar në Gjykatë vendimin e Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës nuk sqaron se cilat të drejta të tij janë shkelur por thekson se lënda e tij lidhur me pronën kontestuese *“nga një gjykatë themelore në Apel lëviz që 11 vite nuk rigjykohet e as nuk gjykohet”*. Lidhur me këtë, ai ankohet se gjyqtari A.G. në kundërshtim me kompetencat ligjore nuk gjykon lëndën e tij duke pretenduar se ka pasur edhe kërcënime lidhur me këtë lëndë dhe se nga këto kërcënime, familja e tij është detyruar të shkojë në Zvicër.
24. Ai po ashtu kërkon që *“lënda të zgjidhet dhe mos të bashkohet me konteste tjera të pa ekzistuar”* dhe se *“Gjykata Themelore –Dega në Lipjan e.nr.296/16 të datës 18.06.2019, i përziën kontestet”* në kundërshtim me dispozitat e

procedurën kontestimore. Ai propozon që lidhur me rastin e tij, “Gjykata e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit të Kosovës që aktgjykimin e sulmuar e.nr.296/16 të dat. 18.06.2019 të ndryshoj dhe kërkesëpadinë të gjykoj dhe rivendos, sepse nuk ka kurrfarë mundësisë që gjykata e shkallës së parë të e përfundoj atë në mënyrë të drejtë”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata i referohet edhe nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, që parasheh:

Neni 22

[Procedimi i kërkesës]

“[...]

4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...]

[...].”

28. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili specifikon:

[...]

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;

[...]

(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës;

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm.

[...].”

29. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

30. Andaj, në vlerësimin nëse përfaqësuesi i pretenduar i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar. Ndërsa, rregulli 32 (2) (e), (q) dhe (h) të Rregullores së punës parasheh që kërkesa e parashtruesve të përmbajë edhe mbrojtjen juridike të kërkuar, arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës si dhe informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
31. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 19 korrik 2021. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, pasi: i) nuk e kishte specifikuar saktë aktin e autoriteti publik që e konteston para Gjykatës; ii) nuk kishte cekur se cilat të drejta kushtetuese pretendonte se i ishin shkelur; si dhe iii) nuk ishin dorëzuar të gjitha vendimet që ndërlidhen me rastin e parashtruesit. Gjykata, më 5 gusht 2021, kërkoi nga parashkruesi i kërkesës që: i) të specifikojë saktë aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston para Gjykatës; ii) t'i sqarojë ankesat sipas Kushtetutës; iii) t'i dorëzojë në Gjykatë kopjet e të gjitha vendimeve që ndërlidhen me rastin e tij; si dhe iv) të njoftojë Gjykatën nëse lidhur me Vendimin e Gjykatës së Apelit, CA.nr.4938/2019, të 5 nëntorit 2020, kishte ushtruar ndonjë mjet juridik.
32. Më 10 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë në të cilën theksoi se lënda e tij “Sot mban këtë numër C.nr. 296/16 pa gjykuar dhe nuk dihet në cilën Gjykatë gjindet në Themelore Apelit ose njëra tjetra nuk me jep informacion”. Në përgjigje të pyetjeve të Gjykatës përmes shkresës së 5 gushtit 2021, ai thekson se kontestohet “*Akti Konkret që toka 5.27 hek, është e imja e paguar më 1980 e dokumentuar nga noterët kontratat e shitblerjes ekspertizat etj.*” Ai po ashtu thekson se ankesat e tij janë “*në të gjitha institucionet e Kosovës duke përfshirë gjykatën e juaj, por është ra në vesht e shurdhur dhe nuk kam përgjigje*” dhe se “*deri më tash i kam dorëzuar te gjitha vendimet e marra nga këto 2 gjykata [...] por nuk kam përgjigje [...]*”. Ai gjithashtu i ka dorëzuar disa dokumente të cilët nuk ndërlidhen me dokumentet shtesë, disa nga të cilët ishin dorëzuar edhe më herët në Gjykatë. Më 24 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C.nr.296/16] të 18 qershorit 2019, dhe Aktvendimin [C.nr.405/19]. Ndërsa më 8 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shtesë, duke përfshirë Aktvendimin [GJA.nr.2020/2021] të

Gjykatës Themelore me të cilin ishte aprovuar kërkesa e Gjyqtarit A.G. për përjashtim nga procedimi dhe vendosja e rastit në çështjen kontestimore C.nr.931/2020.

33. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se përkundër kërkesës specifike të Gjykatës, parashtruesi i kërkesës: i) nuk e ka specifikuar aktin e autoritet publik që e konteston; ii) nuk kishte specifikuar të drejtat e tij sipas Kushtetutës; si dhe iii) nuk i kishte dorëzuar të gjitha vendimet që ndërlidhen me rastin e tij, në rastin konkret, vendimin e Gjykatës së Apelit, të 5 nëntorit 2020.
34. Andaj, në bazë të Rregullores së saj të punës, Gjykata nëse konstaton se kërkesa është e paplotë ose e paqartë mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...]”

35. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesës (shih rastet e Gjykatë Kushtetuese: KI137/20, parashtrues *Ali Latifi si përfaqësues i pretenduar i M.S.*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 24; KI89/18 *Agim Jashari*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29; dhe KI48/17, *Sladana Radojković-Marinković*, Gjykata Kushtetuese, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21).
36. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 21, 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 32 (2) (e) dhe (h) të Rregullores së punës.
37. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 48 dhe të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (2) (e) dhe (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selyete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

